

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6594
E premte, 29 prill 2022
çmimi 0.40

Ushtria Çlirimtare e Kosovës
nuk kishte as kohë as mundësi
për të bërë krime | **FAQE 3**



Shkruan: Kudusi LAMA

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE



**BIDENI KËRKON TË PËRDOREN
ASETET E OLIGARKËVE RUSË PËR
UKRAINËN** F. 2

**ZELENSKY DO T'I DREJTOHET
KUVENDIT TË SHQIPËRISË
MË 3 MAJ** F. 5

**ISH-AMBASADORI GJERGJ DEDAJ
DHE SALI BISLIMI PRITEN NË TAKIM
NGA PAT COX** F. 6

EKONOMI



**BSPK-JA VENDOS QË
MË 12 MAJ TË MBAJË GREVË NË
GJITHË SEKTORIN PUBLIK** F. 8

**MINISTRI PEÇI: BASHKËPUNIMI
NDËRINSTITUCIONAL
PO E AVANCON SEKTORIN
PYJOR NË KOSOVË** F. 7

SPORT



**UEFA MË 11 MAJ DO TË DISKUTOJË
PËR NDRYSHIMET E REJA NË LIGËN
E KAMPIONËVE** F. 10

DRITAN ABAZOVIQ, KRYEMINISTRI I TRETË SHQIPTAR NË BALLKAN

PUSHTETI DHE OPOZITA, PROPOZIME TË NDRYSHME
RRETH HETIMEVE PËR ENERGJINË | **FAQE 4-5**

OPOZITA: KURTI NUK DO TË MUND TA NDALË THEMELIMIN E KOMISIONIT HETIMOR PËR ENERGJINË



Deputetët kanë diskutuar të enjten për themelimin e një komisioni hetimor parlamentar për menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Kosovës. Në diskutim kanë qenë dy komisione hetimore për energjinë. Njëri është iniciuar nga PDK-ja dhe është përkrahur nga LDK-ja dhe AAK-ja. Komisioni tjetër është propozuar nga partia në pushtet, LV-ja. Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, në seancën e Kuvendit ka thënë se Albin Kurti nuk mund ta ndalë këtë hetim pavarësisht prej tendencave për ta vonuar atë

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
E-mail: renova@mt.net.mk
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Dritan Abazoviq, kryeministri i tretë shqiptar në Ballkan

Dritan Abazoviq është zgjedhur kryeministër i Malit të Zi pasi mori besimin e 45 deputetëve të Kuvendit malazez. Ndërsa, në seancën e jashtëzakonshme kundër Abazoviq votuan 3 deputetë, të cilët duket se nuk besuan në aftësitë e Abazoviqit për të drejtuar me qeverinë malazeze.

28 prilli do të shënjojë një rast unik në historinë e shqiptarëve. Kjo pasi me votimin e Abazoviqit për kryeministër të Malit të Zi, për herë të parë në historinë moderne, tre vende të Ballkanit Perëndimor udhëhiqen nga shqiptarët.

Krahas Abazoviqit, Edi Rama është timonieri i Qeverisë së Shqipërisë dhe Albin Kurti udhëheq me Qeverinë e Kosovës, një zhvillim politik i paparë deri në prill të 2022.

Por, si u bë që Ballkani Perëndimor t'i ketë tre kryeministra që etnikisht janë shqiptar?

Më së gjati në postin e kryeministrit është lideri i Partisë Socialiste, Edi Rama.

Një politikan tashmë veteran, Rama udhëheq me Shqipërinë nga viti 2013, duke e fituar tri herë radhazi besimin e shqiptarëve.

Që 11 vite, Rama është politikani më i popullarizuar i Shqipërisë, ndonëse qeverisja

e tij është kritikuar fortë për arsye të korrupsionit e sjelljeve autoritare të liderit socialist.

Në vitin 2021, Rama e rifitoi edhe një mandate në krye të Kryeministrisë, duke u bërë një nga politikanët më jetëgjatë të Shqipërisë pas rënies së komunizmit në vitet 90-ta.

Ani pse u zgjodh dy herë kryeministër i Kosovës, Albin Kurti nuk i ka as dy vite në krye të ekzekutivit kosovar.

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje për herë të parë u zgjodh kryeministër i Kosovës në vitin 2020, kur partia e tij doli e para në zgjedhjet e tetorit të 2019.

Megjithatë, qeveria e tij e parë ishte jetëshkurtër, duke u rrëzuar nga një mocion mosbesimi i Kuvendit të Kosovës.

Por, Kurti arriti të fitojë përsëri zgjedhjet e shkurtit të 2021 dhe atë me një shumicë prej 50,2%. E kjo i siguroi një mandat të dytë Kurtit, i cili mori drejtimin e ekzekutivit kosovar në mars të vitit të kaluar.

Kryeministri i tretë shqiptar në Ballkanin Perëndimor e mori këtë epitet sot pasdite.

37 vjeçi Abazoviq mori besimin e 45 deputetëve të Kuvendit të Malit të Zi, e cila mbajti një mbledhje të jashtëzakonshme këtë të enjte.

Ndonëse si lider i partisë qytetarë Aksioni i Bashkuar Reformist (ABR-URA) ka vetëm 4 deputetë, Abazoviq mori të



drejten e mandarit nga presidenti malazez, Millo Gjukanoviq. Një 'fat' i tillë i buzëqeshi liderit shqiptar pasi që Kuvendi i Malit të Zi me anë të një mocioni të mosbesimit e rrëzoi qeverinë e Zdravko Krivokapiqit, i cili njihej si pro serb.

Ndër arsyet kryesore të

rrëzimit të qeverisë së mëparshme në Mal të Zi ishin çështjet e kishës ortodokse serbe dhe orientimi pro rus i ekzekutivit malazez në politikën e jashtme.

Madje, deklarata e ministrit të Pakicave ngjalli shumë reagime, pasi që i njëjti nuk e kishte cilësuar si gjenocid

ndodhitë në Srebrenicë. Ndaj kësaj deklarate, atëbotë pati reaguar edhe Abazoviq, i cili kishte kërkuar shkarkimin e Vladimir Leposaviq.

Në deklarimin e tij, lideri i ABR-URA pati thënë se në Srebrenicë ka ndodhë gjenocid dhe se një gjë e tillë nuk të mohohet.

Bideni kërkon të përdoren asetet e oligarkëve rusë për Ukrainën



UASHINGTON, 28 PRILL - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Joe Biden, po i kërkon Kongresit Amerikan të enjten kompetenca të reja për t'i kapur dhe ripërdorur asetet e oligarkëve rusë për ta ndihmuar Ukrainën në mbrojtjen e saj kundër pushtimit rus.

Bideni do të kërkojë miliarda dollarë në shpenzime shtesë të ShBA-së të destinuara për furnizimin e ushtrisë së Ukrainës, forcimin e ekonomisë së saj dhe mbështetjen e miliona refugjatëve që u larguan nga pushtimi rus dy muaj më parë.

Ai, gjithashtu, do të kërkojë kompetenca të reja nga Kongresi për t'i forcuar sanksionet e ShBA-së kundër qeverisë ruse dhe atyre që përfitojnë prej saj, tha Shtëpia e Bardhë.

Bideni po u kërkon ligjvënësve që të bëjnë vepër penale për një person që "me vetëdije ose qëllim të zotërojë të ardhura të

përfituara drejtpërdrejt nga marrëdhëniet korruptive me qeverinë ruse" dhe ta zgjerojë përkufizimin e "shantazhit" sipas ligjit të ShBA-së për t'i përfshirë përpjekjet për t'iu shmangur sanksioneve.

Bideni do t'i kërkojë Kongresit të lejojë që qeveria federale t'i përdorë të ardhurat nga shitja e asetëve të sekuestruara të oligarkëve rusë të sanksionuar për ta ndihmuar popullin e Ukrainës.

Në një fjalim virtual drejtuar drejtuesve të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore javën e kaluar, presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskyy bëri thirrje që të ardhurat nga pronat e sanksionuara dhe rezervat e Bankës Qendrore të përdoren për ta kompensuar Ukrainën për humbjet e saj.

Ai tha se asetet e ngrira ruse "duhet të përdoren për ta

rindërtuar Ukrainën pas luftës, si dhe për të paguar për humbjet e shkaktuara kombeve të tjera". Sekretarja e Thesarit, Janet Yellen, tha në atë kohë se do të nevojiteshin veprime të Kongresit për të autorizuar veprime të tilla.

Lufta ka shkaktuar tashmë më shumë se 60 miliardë dollarë dëme në ndërtesa dhe infrastrukturë në Ukrainë, tha javën e kaluar presidenti i Bankës Botërore, David Malpass. FMN-ja në parashikimin e saj të fundit të perspektivës së ekonomisë botërore tha se ekonomia e Ukrainës do të tkurret me 35 për qind këtë vit dhe vitin e ardhshëm.

Lufta në Ukrainë filloi më 24 shkurt ndërsa që nga ajo kohë shumë shtete perëndimore kanë sanksionuar Rusinë në përpjekje për ta ndaluar pushtimin.

“Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale” apo luftë çlirimtare e Kosovës? (6)

Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk kishte as kohë as mundësi për të bërë krime



Shkruan: Kudusi LAMA

Po Gjykata Speciale heton krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të kryera kundër serbëve e bashkëpunëtorëve të tyre shqiptarë, e në atë periudhë ajo ushtri nuk kishte as kohë as mundësi të bënte krime. Kjo sepse luftonte në një terren të pushtuar nga armiku, i cili dispononte armët më moderne të kohës dhe njihte çdo cep të hapësirave të Kosovës se e mbante të pushtuar prej një shekulli dhe kishte forca e mjete të bollshme për t’i përdorur kundër një populli për të cilin nuk ndjente fare dhimbje dhe ishte i gatshëm ta shfaroste. Ushtria Çlirimtare e Kosovës, duke u krijuar në gjirin e popullit shqiptar, nuk kishte as kohë as mundësi të merrej me krime, e të programonte e zbatonte plane kriminale, se kishte shumë punë të tjera më të vlefshme; siç ishin: organizimi, trajnimi, furnizimi, gjetja e mjeteve të nevojshme financiare për të përballuar kërkesat e luftës etj. Nuk kishte as kohë as mjete për të harxhuar me zbatim planesh kriminale, prandaj edhe si dëshmitar i kohës, jam i bindur se as në mendje nuk u shkante as luftëtarëve e as komandantëve të merreshin me çështje, për të cilat i ka marrë nën hetim kjo prokurori e gjykatës speciale.

Prokuroria dhe Gjykata Speciale nuk janë në misionin për të cilin janë krijuar

Pra, a mos kjo prokurori dhe gjykatë nuk po bëjnë atë detyrë që kanë me ligj, por po ndërmarrin veprime politike, në vend që të marrin veprime juridike? A do të vijë një ditë që kjo prokurori e gjykatë të japin llogari për këtë shkelje të ligjit në sy të të gjithë botës? Nëse mendojnë se nuk vjen e kanë gabim. Historia ecën vetëm përpara, nuk ka për të prapaktim.

Kjo Gjykatë kur është krijuar, ishte qëllimi të mundësohet krijimi i bazës ligjore dhe institucionale të besueshme në Kosovë, që të hetonte krimet e pretenduara se janë kryer gjatë viteve 1998-2000 në Kosovë dhe të ndërmerre hapat të procedimit të këtyre veprave. Por jo të godiste drejtuesit kryesor politik të shtetit, me synimin për të kriminalizuar luftën në tërësi dhe për t’i dhënë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës emërtimin që i ka vënë Serbia që në vitin 1997 -

“Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale”.

Sapo të ballafaqohesh me këtë emërtim, kupton hapur synimet e prokurorisë speciale dhe të gjykatës speciale, që realisht kanë rrëshqitur në nazizëm të pastër. As që ka ndonjë ndryshim midis prokurorisë hitleriane e gjykatave hitleriane dhe kësaj prokurorie e gjykatë që nuk e di për çfarë arsye thirren speciale.

Është pritur që kjo gjykatë të mos merretë në dorë politikën botërore kundër-Kosovë, që ka për synim të viktimizojë Serbinë në luftën midis Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në njërën anë dhe ushtrisë jugosllave, policisë jugosllave, forcave paramilitare serbe, forcave kriminale serbe dhe popullsisë civile serbe të armatosur në anën tjetër. Por të kryej detyrat ligjore kundër-kriminale, mision për të cilin e ka krijuar Parlamenti i Kosovës.

Kjo Gjykatë dhe kjo prokurori e keqpërdori bashkëpunimin e liderëve të Kosovës, e keqpërdori votën e ligjëbërësve të Kosovës, e keqpërdori autoritetin që i dha Kosova, vetëm që të kryej një mision mafioz që i ka dhënë dikush tjetër për të kriminalizuar Kosovën dhe Luftën e saj Çlirimtare, nëpërmjet tentativës për të vënë në bankën e kriminelit çdo luftëtar të UÇK-së.

Dhe kjo shumë thjeshtë “Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale”.

“Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale”

Po si funksionojnë Ndërmarrjet e Përbashkëta Kriminale? A ka një përkufizim për këtë?

Sepse që të jesh ndërmarrje - do të thotë: njësi themelore e organizimit të prodhimit, (luftës, krimi etj.), ose disa njësi të tilla të bashkuara me drejtim të përbashkët. Por nuk mund të ketë ndërmarrje që të veprojë e të arrijë synimet e saj sipas objektivave që ka vënë para vetes, në qoftë se nuk janë bërë më parë planet që do të arrihen, vizioni i ndërmarrjes, fushëveprimi, hapësira strategjike e veprimtarisë së kësaj ndërmarrjeje. Prandaj një ndërmarrje, që të quhet e tillë duhet të ketë ndërtuar një plan strategjik mbi të cilin do të mbështesë veprimtarinë e saj dhe do të shtrijë fushëveprimet. A ka një ndërmarrje të tillë në dokumentacionin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës? Ta dinë të gjithë ata që duan ta dinë se, nuk ka asnjë fjalë të shkruar në planet strategjike politike e ushtarake të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Për këtë të jeni të sigurt. Askush mos të dyshojë se ka një plan të tillë në gjithë dokumentacionin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Termi i dytë i emërimit është - e përbashkët - çfarë kuptojmë me

këtë? - që u përket dy a më shumë vetave, që i përket një grupi njerëzish, që përdoret a shfrytëzohet nga të gjithë, që i përket gjithë popullit, gjithë shoqërisë; që bëhet së bashku me një tjetër a me të tjerë; kolektiv; që është i njëjtë ose po ai për dy a më shumë veta a për të gjithë. Pra, lufta për çlirimin e Kosovës ishte një ndërmarrje e përbashkët e popullit të Kosovës, përfaqësuar nga Ushtria Çlirimtare, për t’u çliruar nga pushtimi e për të shpëtuar trojet e tij nga kolonizimi serb. Dhe kjo është e saktë sepse për këtë ka plan strategjik politik - ushtarak të hartuar e pranuar nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së. Po le të kthehemi te termi i fundit, - kriminale - do të thotë - që përbën krim a që synon të kryej një krim; që është i dëmshëm për shtetin, për shoqërinë a për ndonjë pjesëtar të saj; që është veprë a veprimtari kriminale, që ka a realizon plane kriminale.

Duket pra se Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale - qenka një ose disa njësi të bashkuara me drejtim, synime dhe plan të përbashkët, të cilat janë kriminale dhe realizohen nëpërmjet një kompleksi krimesh, të cilat kanë si qëllim final të dëmtojnë shtetin e shoqërinë.

Kush ka të drejtë të etiketojë kështu Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës? Kush ka të drejtë ligjore ta konsideroj dhe emërtoj atë organizatë kriminale? Kush ka të drejtë ta quaj Luftën Çlirimtare të Kosovës veprë kriminale?

A duhet lejuar kjo prokurori naziste dhe kjo gjykatë zvarritëse ta bëjë këtë?

Mendoj që jo. Mendoj që duhet të ngrihem në këmbë të gjithë t’i tregojmë botës se ne e dimë cila është drejtësia. Mendoj se nuk duhet që kjo prokurori e gjykatës speciale të na trajtojnë si budallenj ligjor. Duhet të tregojmë që edhe ne dimë ta njohim ligjin dhe kemi kapacitete të kërkojmë zbatimin e tij. Nuk dua të kërkoj favorizim e lehtësim prej këtyre institucioneve speciale, por vetëm drejtësi, që për fat të keq nuk po duan ta japin.

Nuk na duhet drejtësia e veshur me petkun politik

Unë dua t’i besoj drejtësisë, por jo atë drejtësi që ia ngjit fajin kujt donë. Dua drejtësinë që zbulon dhe dënon autorët e krimin. Nuk e dua drejtësinë të veshur me kostum politik, por dua atë drejtësi të veshur me kostumin e ligjit. Dua drejtësinë që bën hetim dhe gjykim të ndershëm, të paanshëm dhe që të përmbushë standardet e së drejtës ndërkombëtare. Të kesh përgjegjësi komanduese e drejtuese nuk do të thotë se je përgjegjës për çdo krim që mund të ndodhë brenda hapësirës së përgjegjësive funksionale. Sepse po të ishte kështu, duhen futur në

burg të gjithë presidentët dhe kryeministrat e qeverive të botës, të gjithë ministrat e brendshëm të qeverive të botës, të gjithë drejtorët e funksionarët e policive të shteteve të botës, të gjithë kryetarëve e bashkive të botës etj. Sepse në zonën e përgjegjësive së tyre ndodhin krime çdo ditë nga të gjitha llojet. Por ata nuk mund të ngarkohen me përgjegjësi ligjore kriminale, sepse nuk janë ata planifikuesit dhe menaxherët e kriminalitetit që ndodhë. Kështu që edhe funksionarët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së janë të këtyre niveleve. A duhet të jenë ata përgjegjës si kriminelë në qoftë se ka ndodhur një krim nga një luftëtar i ushtrisë që ata kanë udhëhequr në luftë? Mendoj që ky është veprim antiligjor, kjo çfarë po ndodhë me këta burra të Kosovës që udhëhoqën luftën për çlirim dhe për këtë tani gjenden të marrë peng nga një prokurori speciale e Kosovës, që vetëm për interesat e Kosovës e të ligjit dhe



drejtësisë nuk punon.

Sot është në burg në Hagë Jakup Krasniqi - zëdhënës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - i akuzuar për krime lufte. Sot është president i Serbisë Aleksandër Vuçiq - zëdhënës i qeverisë së Jugosllavisë së mbetur nën Milosheviqin, që me ushtrinë, policinë, forcat paramilitare dhe ato kriminale e qytetarët serb të armatosur - gjithsej rreth 150 mijë trupa me programe e plane për vrasjen e masakrimin e shqiptarëve dhe me plane luftimi për të shkatërruar gjithçka në hapësirat e Kosovës, - është pra udhëheqësi i Serbisë dhe nderohet e përkëdhelet nga udhëheqësit e shteteve të Europës.

Pyetja ime është: Cili nga këta të dy burra është realisht kriminel që duhet të jetë në burg? Jakup Krasniqi që ka luftuar të çlirojë atdheun, apo Aleksandër Vuçiqi që ka udhëhequr gjenocidin mbi një komb të tërë për ta vrarë, siç e ka vrarë, për ta masakruar siç e ka masakruar, për ta zhdukur siç e ka zhdukur dhe për ta shpërngulur siç e ka shpërngulur?

A ka vërtetë njerëz të ligjit që nuk e kuptojnë kaq monstruoze, kaq padrejtësi, kaq banalitet të mbështetur në ligj, kaq politikë që përdhunon ligjin, kaq mospërfillje

ndaj qytetarisë, kaq shpërfillje të lirisë, kaq diferencim kombëtar. Kaq zvetënim personaliteti, kaq ligësi, kaq veprim kundërnjerëzor e kundërqytetar? Mendoj se nuk duhet të ketë të tillë. Por realisht gjykata speciale e krijuar nga Kosova kundër Kosovës në Hagë është duke vepruar si një institucion që këto elementë jam i sigurt se i njeh, por përballë interesave të veta dhe urdhrave politik nuk i shikon dhe nuk i vlerëson.

Jam i bindur, se nëse prokurorët e gjykatës speciale për krimet e luftës së UÇK-së në Hagë, do t’i nënshtrohen profesionalizmit dhe drejtësisë, ata burra i lirojnë brenda ditës duke u kërkuar edhe falje që i kanë trajtuar në mënyrë të tillë. Por çfarë t’i bësh faktit që ata kanë marrë detyra të tilla dhe për këtë kanë edhe shpërblime e pagesa të jashtëzakonshme. Është vështirë të mos zbatosh detyrën dhe është shumë vështirë t’i

kthesh shpinën një pasurie të tërë që të vjen pa asnjë lodhje.

Jam i sigurt, se po të pyeten prokurorët, a janë të bindur se janë fajtorë ata burra të luftës që i kanë mbyllur në atë burg, po të jenë profesionistë të ndershëm, përgjigja e tyre do të jetë: Jo. Dhe po të pyeten a dëshirojnë të marrin pafajësinë ata burra, përgjigja e tyre do të jetë: Jo. Le të jenë të ndershëm për një çast ata prokurorë dhe le të thonë nëse unë kam të drejtë që kam dalë në këtë përfundim ose jo.

Por duke qenë se kjo gjykatë punon me prova të ofruara nga Beogradi, që janë plotësisht shpifje të ulëta, të cilat kjo gjykatë i ka marrë për plotësisht të vërteta, sepse pikërisht viktimizimi i Serbisë është edhe funksioni real i kësaj gjykate, megjithëse jo funksioni ligjor. Prandaj edhe jam i bindur, se po të ketë një institucion që ta kontrollojë këtë gjykatë nëse punon ose jo me prova serbe të ndërtuara nga forcat serbe të sigurisë, do të gjente se përveç provave të montuara nga Serbia, asgjë tjetër nuk ka në dosjet e atyre prokurorëve dhe gjykatësve. Kjo sinjorisht është e pa ndershme, pa folur se është kundërnjerëzore dhe kundërqytetare e kundërligjore. (Vijon)



PUSHTETI DHE OPOZITA, PROPOZIME TË NDRYSHME RRETH HETIMEVE PËR ENERGIJINË

Opozita: Kurti nuk do të mund ta ndalë themelimin e Komisionit Hetimor për Energjinë

Deputetët kanë diskutuar të enjten për themelimin e një komisioni hetimor parlamentar për menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Kosovës. Në diskutim kanë qenë dy komisione hetimore për energjinë. Njëri është iniciuar nga PDK-ja dhe është përkrahur nga LDK-ja dhe AAK-ja. Komisioni tjetër është propozuar nga partia në pushtet, LV-ja. Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, në seancën e Kuvendit ka thënë se Albin Kurti nuk mund ta ndalë këtë hetim pavarësisht prej tendencave për ta vonuar atë

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 PRILL - Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë diskutuar të enjten për themelimin e një komisioni hetimor parlamentar për menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Kosovës. Në diskutim kanë qenë dy komisione hetimore për energjinë. Njëri është iniciuar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe është përkrahur nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Komisioni tjetër është propozuar nga partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje (LV). Partitë opozitare kanë thënë se

komisioni i tyre do t'i analizonte të gjitha masat e marra prej periudhës së shpalljes së gjendjes emergjente për energjinë, për të cilën Kuvendi ka votuar në fund të vitit të kaluar.

Komisioni i propozuar nga LV-ja do të hetonte më shumë çështje në sektorin e energjisë.

Disa nga to janë: hetimi i investimeve kapitale në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) në periudhën 2006-2022, investimet kapitale në distribucionin e energjisë elektrike pas privatizimit dhe burimet nga ku janë bërë ato investime.

LV-ja, po ashtu, propozon të hetohen edhe punësimet e bëra nga viti 2006 deri në prill të këtij viti, kontratat e lidhura për blerje

të energjisë elektrike nga viti 2006 deri më 2022, procedurat e ndjekura gjatë këtyre blerjeve dhe shumë çështje të tjera në fushën e energjisë.

Shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka propozuar që në komisionin hetimor për energji të përfshihen edhe këto çështje, në të kundërtën deputetët e kësaj partitë nuk do të votojnë. "Nëse dëshirojmë të jemi transparentë, po e zgjerojmë gamën e hetimit në sektorin e energjisë që do ta bëjë komisioni hetimor në sektorin e energjisë", ka deklaruar Kusari-Lila.

Me këtë propozim nuk është pajtuar shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri. Ai ka thënë se

komisioni hetimor ka mandat gjashtëmuor për të bërë hetime dhe, sipas tij "është e pamundur të hetohen të gjitha çështjet brenda kësaj periudhe".

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, në seancën e Kuvendit ka thënë se Albin Kurti nuk mund ta ndalë këtë hetim pavarësisht prej tendencave për ta vonuar atë. Sipas Krasniqit, nuk ka ndodhur asnjëherë në historinë e parlamentarizmit në Kosovë, që të devijohet nga rregulli i praktikës demokratike parlamentare, siç po bën mazhoranca tani. "Është për keqardhje fakti që në këtë Kuvend për shkak të arrogancës të numrave të fuqishëm që e keni si shumicë e pushtetit, e keni shndërruar në tifozëri sepse ky s'është mandati i deputetit. Hetimi parlamentar si instrument në esencë është instrumenti kryesor që e ka opozita në dispozicion jo pushteti, sepse vetë fjala pushtet tregon që ju i keni krejt të tjerat. Përtej kësaj hetimi parlamentar është raporti që e krijon Kuvendi me qeverinë që e

ka zgjedhur. Pra ne këtë legjislaturë në kuptimin legal kemi të drejtë ta hetojmë punën e qeverisë që e ka zgjedhur ky Kuvend i kësaj legjislature dhe institucionet që kanë buruar prej kësaj legjislature ose që ndërlihen me të", ka theksuar kryetari i PDK-së.

Ai ka thënë se mazhoranca sot po tenton ta pamundësojë formimin e Komisionit Hetimor sipas kërkesës së opozitës, duke e privuar atë nga një e drejtë bazike që ia garanton ligji. "Ne po kërkojmë të hetohet pse ka ardhur deri te kjo situatë dhe në fund të shtatorit për herë të parë e kemi ngritur çështjen e krizës. Në tetor kemi dalë me rekomandime konkrete për të bërë kontratë afatgjatë. Bënte hajgare kryeministri i Kosovës, duke thënë se nuk ruhet rryma në frigorifer, e tash po del që po bëka me softuerë që mundesh me ble për më vonë", ka deklaruar Krasniqi. Lideri i PDK-së, duke iu drejtuar deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje, ka thënë se mandatin e deputetit nuk ia kanë

Zelensky do t'i drejtohet Kuvendit të Shqipërisë më 3 maj

TIRANË, 28 PRILL - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky do t'i drejtohet Kuvendit të Shqipërisë më 3 maj përmes videolidhjes, kanë njoftuar mediet në Shqipëri.

Zelensky do t'i drejtohet Shqipërisë në vazhden e adresimeve që ai ka bërë nga fillimi i luftës nëpër parlamente të vendeve evropiane dhe vendeve të tjera aleate të cilat e kanë përkrahur Ukrainën në përballjen me pushtimin rus të nisur më 24 shkurt.

Adresimi në Kuvendin e Shqipërisë pason një telefonatë që Zelensky i ka bërë kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, në javët e para të luftës në Ukrainë, për t'iu falënderuar këtij të fundit për përkrahjen dhe kontributin e Shqipërisë ndaj Ukrainës.



Shqipëria është rreshtuar me Bashkimin Evropian dhe NATO-n në mbështetjen e Ukrainës,

duke bashkëvepruar me aleatët për vendosjen e sanksioneve ndaj Rusisë dhe duke kontribuar

në koordinimin politik në NATO dhe Këshillin e Sigurimit të OKB-së për ta dënuar pushtimin rus.

Autoritetet shqiptare, gjithashtu, kanë përkrahur rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së që dënon sulmin rus në Ukrainë dhe, së fundi, kanë nisur iniciativë për dokumentimin dhe hetimin e krimeve të luftës përmes OKB-së në këtë konflikt. Ndonëse Shqipëria nuk varet nga gazi rus dhe nuk ka ndonjë marrëdhënie të theksuar tregtare me Rusinë dhe Ukrainën, edhe ajo është përballur me rritje të çmimeve si pasojë e luftës. Përkundër një sërë masash të ndërmarra nga qeveria shqiptare për t'i adresuar pasojat ekonomike dhe koston e produkteve elementare, përfshirë energjinë elektrike, pakënaqësia sociale është manifestuar me protesta të shumta gjithandej Shqipërisë, ndër shtetet më të varfra në Evropë.

Ministri Latifi prezanton shtatë shtyllat e programit të tij për shëndetësinë

PRISHTINË, 28 PRILL (ER) - Ministri i Shëndetësisë ka prezantuar para përfaqësuesve të institucioneve shëndetësore, të odave të profesionistëve shëndetësor, Shoqatës së të drejtave të pacientëve dhe akterëve të tjerë brenda sektorit shëndetësor programin e tij për shëndetësinë "Rruga drejt transformimit".

Në këtë takim mori pjesë edhe zëvendëskryeministrja Emilia Rexhepi dhe këshilltari për shëndetësi i kryeministrit Kurti, Jusuf Ulaj.

Prezantimi u bë në kuadër të takimit gjithëpërfshirës për prezantimin e politikave të Ministrisë së Shëndetësisë, gjatë të cilit, përfaqësues të institucioneve të ndryshme prezantuan, gjithashtu, aspekte dhe të dhëna të ndryshme që kanë të bëjnë me studimet e fisibilitetit dhe infrastrukturën shëndetësore, shërbimet klinike dhe listat e pritjeve për trajtime jashtë institucioneve shëndetësore publike, Fondin e Sigurimeve, tre

nivelet e Kujdesit Shëndetësor, sfidat e ballafaqimit me Covid-19 dhe tematika të tjera.

Pasi ka bërë një elaborim të detajuar rreth gjithë asaj me çka është përballur në sektorin shëndetësor që nga marrja e mandatit, ministri Latifi ka theksuar se digjitalizimi i shërbimeve shëndetësore, përfshirë sigurimet shëndetësore; Kthimi i "trurit" të humbur dhe ruajtja e trurit shëndetësor që ekziston tani, përmes programeve konkrete në shëndetësi; Qendrat klinike të ekselencës dhe shërbimet e avancuara klinike; Kërkimet shkencore dhe krijimi i kapaciteteve hulumtuese; Proceset e akreditimit ndërkombëtar; Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve mjekësore dhe - Decentralizimi i sistemit spitalor dhe ri-organizimi i ShSKUK/KQKUK, janë shtatë shtyllat e programit të tij për shëndetësinë.

Ai i elaboroi ndërhyrjet që duhet bërë me qëllim që të arrihen



rezultatet e pritura që kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve njerëzore në shëndetësi dhe sigurimin e shërbimeve dhe kujdesit shëndetësor cilësor. "Pacienti në qendër të vëmendjes, politika të bazuara në dëshmi shkencore, orientim në hulumtime dhe shtytje e tyre përmes

teknologjisë", janë parimet të cilat duhet të na udhëheqin në punën tonë", ka thënë ministri Latifi.

Ai ka përmendur se krahas intervenimeve në infrastrukturë dhe riorganizim, krijimi i disa qendrave si Qendra e Emergjencës dhe Traumës; Qendra për kancer të Gjirit, pastaj programet e

integruara dhe të avancuara në Onkologji; Kirurgjia endoskopike; Qendra e avancuar e Neurokirurgjisë, etj., do të jenë pjesë e programit të tij, ndërkohë që adresoi edhe sfidat e kuadrin deficitar në Anestezioloji dhe Kujdes Intensiv si dhe në lëmi të tjera të cilat do të trajtohen.

borxh qeverisë, por qytetarëve që i kanë votuar, e tani po e paguajnë rrymën 100 për qind më shtrenjtë. Ai ka treguar se qeveria Kurti për herë të parë i ka kthyer restriksionet në Kosovë dhe përmes ZRRE-së e ka shtrenjtuar energjinë, Bordi i së cilës me arrogancë ka refuzuar t'i pezullojë tarifën e shtrenjtuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Ndërkaq kryetari i Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, deputeti Ferat Shala, ka shtuar disa pyetje për deputetët e pozitës dhe qeverinë. "Pse kjo frikë që të mos ballafaqoheni me fakte dhe argumente para Komisionit Hetimor për

Energjinë? Pse po frikësohet qeveria që t'i bëjë transparente dokumentet e shitblerjes së energjisë? Pse po i fshihni veprimet tuaja? Pse KEK-u të mos i bëjë transparente kontratat njëburimore dhe të gjitha të tjerat? Pse ne të mos e dimë gjendjen financiare në KOST?", ka pyetur Shala.

Kryetari i AAK-së, deputeti Ramush Haradinaj, ka thënë se Vetëvendosja, duke kundërshtuar çdo investim në energji, me vite të tëra ka mbrojtur interesa të kompanisë serbe. "Për sigurinë e vendit jemi bashkë, por për interesat politike të nipave të Stanishiqit dhe Rankoviqit, na

keni kundër", ka thënë lideri i AAK-së.

Ai ka thënë se partia në pushtet po hesht për skandalin e ambasadorit dhe po tenton që të ikë prej debatit duke hapur tema të tjera, deri edhe të pagjeturit. "Dilni nga kjo gjendje vetë, se nuk mund t'ju nxjerrë askush", ka deklaruar Haradinaj.

Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), gjatë seancës së Kuvendit të Kosovës, ka thënë se nuk do ta shkrijnë kërkesën e 40 deputetëve që vjen nga Partia Demokratike e Kosovës, në kërkesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LV).

Gashi ka thënë se nuk ka ndodhur

asnjëherë që kërkesës së 40 deputetëve t'i ndërrohen objektet, kohëzgjatja, hetimi dhe fusha e veprimit. "Kosova ka formuar disa komisione hetimore parlamentare. Asnjëherë në krejt këto komisione hetimore asnjë shumicë nuk e ka ndryshuar objektin, kohëzgjatjen e hetimit dhe fushën e veprimit. E sot çka po ndodh? Kusari del e thotë se ne e kemi propozuar një komision tjetër, e ju duhet ta shkruani atë komision, e kjo nuk do të ndodhë. Kërkesa e Abelard Tahirit duhet të formohet. Kërkesa e 40 deputetëve nuk mund të ndryshohet. Kurrë s'e kemi bërë praktikë për të ndryshuar.

Pushteti tenton të mbytet një kërkesë të tillë parlamentare me veprimet e mosveprimet. Dhe unë i them, po, hajde t'i hetojmë vitet e kaluara, dhe e votojmë një komision të tillë, por të jetë komision tjetër i veçantë. E ky është kërkuar sipas fushës. Duhet të votohen dhe jo të ndryshohen. Nëse kjo ndodh, atëherë kemi përmbyse të sistemit të vlerave demokratike. Sot do të përplasemi dhe do të përplasemi keq. Propozoj kryetar të këtij komisioni, Driton Selmanaj, i cili nuk është nënshkruar i këtij komisioni që në nismë është shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri", ka thënë Gashi.

Ish-ambasadori Gjergj Dedaj dhe Sali Bislimi priten në takim nga Pat Cox

LOZANË, 28 PRILL (ER) - Ish-ambasadori i Kosovës në Maqedoninë e Veriut, Gjergj Dedaj, i shoqëruar edhe nga bashkëpunëtori dhe veprimtari Sali Bislimi, kanë vizituar selinë

e Fondacionit "Jean Monnet" për Evropën në Lozanë të Zvicrës. "Pat Cox, president i këtij fondacioni dhe ish-president i Parlamentit Evropian, na njoftoi me jetën

dhe veprën historike të Jean Monnet, i cili ndryshe quhet edhe 'baba i Evropës', i legjislacionit dhe krijimit të Bashkimit Evropian dhe integritetit euroatlantik të kontinentit evropian pas Luftës së Dytë Botërore. Me presidentin Cox biseduam edhe për situatën aktuale pas agresionit rus në Ukrainë dhe pasojat e kësaj lufte në botë dhe Evropë. Hezitimi i Evropës për procesin e zgjerimit nuk është shumë i qëlluar, prandaj edhe Ukraina dhe vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të përfshihen në agjendën e integritetit euroatlantik, si dhe të anëtarësimin në BE dhe NATO!", ka shkruar Dedaj në logarinë e



vet në "Facebook". Ish-ambasadori i Kosovës në Maqedoninë e Veriut, Gjergj Dedaj, dhe drejtori i organizatës joqeveritare "Zëri Perëndimor i

Kosovës", Sali Bislimi, kanë qenë të ftuar në konferencën e organizuar për luftën në Ukrainë nga Fondacioni "Jean Monnet" për Evropën.



Kosova paraqet projektet që do të financohen përmes IPA 2023



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 28 PRILL - Të enjten është mbajtur takimi kryesor ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe delegacionit të nivelit të lartë nga Komisioni Evropian në kuadër të misionit për programimin e IPA 2023 dhe hapat e parë rreth investimeve nga WBIF.

Delegacioni i qeverisë u kryesua nga zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Besnik Bislimi, ndërsa delegacioni nga Komisioni

Evropian u përfaqësua nga Vassilis Maragos, shefi i Njësisë për Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Kosovën dhe Holger Schroeder, shefi i Njësisë për Programet Rajonale dhe Planin e Investimeve Ekonomike (EIP), në Drejtorinë e Përgjithshme të Komisionit Evropian për Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit.

Në takim u prezantuan projektet e përgatitura nga ana e institucioneve vendore, të cilat do të financohen përmes IPA 2023, me theks në maturitetin e tyre si

dhe qasjen sektoriale. Këto projekte do të përfshihen në IPA 2023 dhe do t'u përkasin fushave dhe sektorëve të ndryshëm si sundimi i ligjit, punësimi, administrata publike, digjitalizimi i qeverisjes, mbrojtja e mjedisit përmes ndërtimit të deponisë për mbetjet e rrezikshme dhe projektit NATURA 2000, investimet në infrastrukturë për rrjetin e transmisionit elektrik dhe energjinë e ripërtëritshme, arsimit me theks në digjitalizim, edukimin në fëmijërinë e hershme, projekti për ndërtimin e sallës koncertale

dhe punësimi përmes skemës për garanci të rinjve në VET (sistemin dual shkollor).

Komisioni Evropian ka përshëndetur përkushtimin e institucioneve të Republikës së Kosovës për të prezantuar projekte të ndërlidhura me prioritetet e integritetit evropian, me tranzicionin energjetik dhe mjedisor, në përputhje me dokumentet strategjike të BE-së për rajonin si dhe projekte relevante për vitin 2023 e tutje.

Takimi u shfrytëzua edhe për informimin rreth mundësive për

përfitim nga Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF) duke përfshirë garancitë bankare dhe zhvillimin e sektorit privat dhe koordinimin e veprimeve në nivel bilateral mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Qeveria e Kosovës do t'i përgatisë projektet shtesë të cilat do të paraqiten për financim nga Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor gjatë muajit qershor, si dhe do të përfshihen në programimin e projekteve të tjera të përkrahura nga programet rajonale.

19 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 28 PRILL (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se pas 723 testimeve, 19 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes.

Të enjten janë shënuar 16 qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shënuarve është 224 470. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 415.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 126 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit

të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 825 885 doza të vaksinës. Deri më sot 821 946 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 101 385 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.



Qeveria ndan shtesat 100 euro për punonjësit e sektorit publik

PRISHTINË, 28 PRILL (ER) - Qeveria e Kosovës ka miratuar kërkesën e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për ndarjen e mjeteve buxhetore për zbatimin e Pakos së Ringjalljes

Ekonomike për masën 3.6 - Mbështetja e likuiditetit familjar. Sipas këtij vendimi, ndahen mjete buxhetore në shumë 7 milionë e 300 mijë euro për zbatimin e pikës 1.4 të vendimit të qeverisë të

datës 13.04.2022, si masë për shtimin e mbështetjes për qytetarët e Kosovës, Masa 3.6 - Mbështetja e likuiditetit familjar të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. "Mjetet e ndara do të merren nga nënprogrami

'Programi i Ringjalljes Ekonomike' dhe ndahen për zbatimin e shtesës prej 100 eurove për punonjësit e sektorit publik që marrin pagë nga buxheti i shtetit", është bërë me dije në njoftimin e qeverisë.



Ambasada Amerikane në Prishtinë: ShBA-ja do të kujdeset për sigurinë në Kosovë



PRISHTINË, 28 PRILL (ER) - Ambasada Amerikane në Prishtinë këtë të enjte ka ripërsëritur deklaratën e ndihmës-sekretares amerikane të Shtetit për Çështje Evropiane dhe Euroaziatike, Karen Donfried, e cila gjatë vizitës në Prishtinë tha se ShBA-ja do të kujdeset për sigurinë në Kosovë.

Donfried ka thënë se "ju siguroj se angazhimi i Shteteve të Bashkuara dhe ai i aleatëve tanë mbetet i fuqishëm". "Dislokimi më i madh i NATO-s, KFOR, është manifestimi më i dukshëm i përkushtimit tonë të vazhdueshëm për sigurinë dhe stabilitetin e Kosovës", ishte shprehur ajo.

Tri ditë më parë Donfried doli në

konferencë për medie bashkë me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, ku, ndër të tjera, tha se ShBA-ja dëshiron një marrëveshje përfundimtare Kosovë - Serbi me njohje reciproke. Ajo ka theksuar se pas luftës në Ukrainë është shumë e rëndësishme që të vazhdohet reforma për t'u integruar në institucionet veriatlantike. "Lufta e pajustificuar dhe brutale në Rusi na ka treguar sa e rëndësishme dhe urgjente është që të punojmë për të siguruar që Kosova dhe fqinjët e saj t'i vazhdojnë reformat e domosdoshme për konsolidimin e demokracisë dhe integrimin e tyre në institucionet euroatlantike", ka thënë Donfried.

Ministri Peci: Bashkëpunimi ndërinstytucional po e avancoon sektorin pyjor në Kosovë

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 PRILL - Task Forca për Mbrojtjen dhe Shfrytëzimin e Ligjshëm të Pyjeve ka miratuar Rregulloren e Punës si dhe e ka formuar Bordin Këshillëdhënës për Pylltari. Aprovimi i këtij dokumenti dhe formimi i Bordit është bërë të enjten gjatë takimit të tretë me radhë të kësaj Task Force, në të cilin kanë marrë pjesë ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, si dhe përfaqësues të institucioneve të tjera qeveritare që janë pjesë përbërëse e kësaj Task Force. Me këtë rast, ministri Peci e ka vlerësuar shumë të rëndësishëm

aprovimin e këtyre dokumenteve për sektorin e pylltarisë pasi që, sipas tij, tashmë po përcaktohet roli i Task Forcës si një organ ndërinstytucional për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e ligjshëm të pyjeve. "Ministria e Bujqësisë tashmë e ka prioritetuar sektorin e pylltarisë përmes hartimit të politikave të duhura pyjore. Në këtë drejtim kemi krijuar Task Forcën për Pyje, si dhe kemi aprovuar në qeveri Ligjin e ri për Pyje dhe i njëjti është proceduar në Kuvend. Po ashtu, kemi hartuar Strategjinë për Zhvillimin e Pylltarisë 2022-2030, e cila tanimë gjendet në zbatim. Hartimi dhe aprovimi i të gjitha këtyre dokumenteve përcjellëse do t'i kontribuojnë zhvillimit dhe menaxhimit të sektorit të pylltarisë", ka thënë ministri Peci, duke shtuar



se do të vazhdojnë edhe përmes projekteve dhe hapave të tjerë për avancimin e sektorit të pyjeve në Kosovë.

Gjatë këtij takimi është bërë me dije se në kuadër të pyllzimeve

MBPZHR-ja deri më tani ka pyllëzuar 309.30 hektarë apo 773 321 fidanë. Ndërkaq, misioni i FAO-s në Kosovë ka pyllëzuar 50 hektarë apo 140 mijë fidanë.

Ndryshe, Bordi Pyjor

Këshillëdhënës, i cili është votuar në këtë takim, ka për mandat ofrimin e këshillave për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet vartëse të saj.

BSPK-ja vendos që më 12 maj të mbajë grevë në gjithë sektorin publik



PRISHTINË, 28 PRILL (ER) - Bashkimi i Sindikatave të Pavarura (BSPK) ka njoftuar se ka vendosur që më 12 maj të mbahet grevë njëorëshe për të gjithë të punësuarit në sektorin publik në shenjë pakënaqësie për mospërfilljen e kërkesës për 100 euro shtesë çdo muaj deri në miratimin e Ligjit për Pagat. Pas takimit me sindikatat, kryetari i BSPK-së, Atdhe Hykollli, ka njoftuar se më 20 maj do të mbahet protestë. "BSPK-ja ka vendosur që

krahas që është hapur një tunel i dialogut social me institucionet tona, më 12 maj kemi vendosur që të fillojmë me një grevë njëorëshe për gjithë të punësuarit e Kosovës dhe protestë më 20 maj", ka thënë Hykollli.

Në anën tjetër, kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, ka njoftuar se pas grevës e protestës, nëse nuk përfillen kërkesat e tyre, do të mbahet grevë e përgjithshme. "Sindikatat do të shkojnë në

grevë të përgjithshme duke e paralizuar edhe sistemin arsimor dhe sektorët e tjerë. Po i japim hapësirë dialogut, e ky veprim do të shihet më 12 maj, me grevën njëorëshe dhe protestën më 20 maj që besoj se do të jetë madhështore", ka deklaruar Jasharaj.

Kujtojmë se rritja e pagave, zbatimi i Ligjit për Sigurimin Shëndetësor dhe ndryshimplotësimi i Ligjit për Skemat Pensionale janë disa nga kërkesat e tjera të sindikatave.

Çfarë qëndron pas vendimit rus për t'i ndërprerë furnizimet me gaz?

PRISHTINË, 28 PRILL - Gazpromi i Rosisë tha se do t'i ndalë furnizimet me gaz natyror për në Poloni dhe Bullgari, duke përshkallëzuar tensionet ndërmjet Kremlinit dhe Evropës për energjinë dhe pushtimin e Ukrainës. Me këtë vendim është shtuar urgjenca që të bëhen plane të reja që fillimisht të zvogëlohet dhe më pas t'i jepet fund varësisë së Evropës nga gazi dhe nafta ruse.

Gjiganti i energjisë ruse, Gazprom, kompani që kontrollohet nga shteti, tha se do t'i ndalojë furnizimet për në Poloni dhe Bullgari, sepse këto dy shtete po refuzojnë që të paguajnë me rubla për gazin rus, ashtu siç ka kërkuar presidenti i Rosisë, Vladimir Putin.

Liderët evropianë thonë se në kontratat për gazin rus thuhet se pagesa bëhet në euro ose dollarë dhe njëra palë nuk mund ta ndryshojë çështjen e pagesës. Polonia ka ndërmarrë hapa afatgjatë për ta mbrojtur veten nga ndalimi i furnizimeve ruse, teksa ka ndërtuar një terminal për import të gazit të lëngshëm që transportohet përmes anijeve dhe kishte planifikuar që në fund të këtij viti t'i ndërpriste furnizimet nga Gazpromi. Bullgaria, në anën tjetër, thotë se tash për tash ka mjaftueshëm gaz. Megjithatë, ngrihet pyetja se çfarë ndikimi mund të ketë njoftimi i Gazpromit në tregjet energjetike teksa janë rritur pasiguritë se furnizimet me gaz natyror mund të ndërpriten edhe për vendet e tjera evropiane që do të mund të shkaktonte një goditje të rëndë për ekonominë.

Kremlini ka paralajmëruar për këtë mundësi nëse shtetet nuk paguajnë me rubla për energjinë. Por, Rusia, po ashtu, varet nga shitjet e naftës dhe gazit për ta financuar qeverinë e saj, teksa sanksionet kanë goditur sistemin financiar rus. Sipas sistemit të ri të pagesave, Kremlini ka thënë se importuesit do të duhet të krijojnë një llogari në dollarë apo euro në bankën e tretë më të madhe ruse, Gazprombank, dhe një llogari të dytë bankare në rubla. Importuesi më pas do të paguante për furnizimet me gaz me euro apo dollarë dhe banka do t'i këmbente menjëherë paratë në rubla.

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, tha më 27 prill se pagesa me rubla shkel sanksionet e Bashkimit Evropian kundër Rosisë dhe se kompanitë që kanë kontrata të furnizimeve "nuk duhet t'i pranojnë kërkesat ruse".

Situata në Ballkan

Gazi rus vjen në Evropë përmes disa gazsjellësve, siç është "Rrjedha Veriore 1" dhe "Rrjedha Turke". Me gazin rus furnizohen edhe disa prej shteteve të

Ballkanit Perëndimor.

Projekti i Rosisë dhe Turqisë, i quajtur "Rrjedha Turke", dërgon gazin rus në Turqi dhe në vendet e Evropës Jugore dhe Juglindore. Serbia është e varur plotësisht nga gazi rus, që vjen përmes Bullgarisë, që është shtet transit. Përveç varësisë nga gazi rus, Gazpromi rus ka krijuar monopol në tregun serb, për çka Bashkimi Evropian ka paralajmëruar prej vitësh.

Bullgaria, po ashtu, pëson 90 për qind të kërkesës së saj me furnizime me gaz nga Rusia, edhe pse kontrata afatgjatë i skadon më vonë gjatë këtij viti. Përmes "Rrjedhës Turke" me gaz rus furnizohen edhe Maqedonia e Veriut, Bullgaria, Bosnjë e Hercegovina, Kroacia dhe Hungaria.

Gazsjellësi "Rrjedha Turke" është pjesë e ambicieve afatgjata të Rosisë për ta minimizuar transportin e gazit përmes Ukrainës dhe për të ofruar alternativë për gazsjellësit "Rrjedha Veriore 1 dhe 2".

Çfarë po kërkon Putini?

Për shkak të urdhrimit të Putinit që pagesat me rubla të prekin vetëm "shtetet jomiqësore", ky vendim mund të shihet si kundërpërgjigje ndaj sanksioneve perëndimore që kanë larguar bankat ruse nga transaksionet ndërkombëtare financiare dhe kanë detyruar disa kompani perëndimore që t'i largojnë bizneset e tyre nga Rusia.

Motivet ekonomike për të kërkuar pagesa me rubla nuk janë të qarta sepse Gazpromi veçse duhet të shesë 80 për qind të fitimeve të saj të huaja për rubla, prandaj shtytja për rimëkëmbjen e monedhës kombëtare ruse do të ishte minimale. Një nga motivet e këtij vendimi mund të jetë politik: për t'i treguar publikut në Rusi se Putini mund të diktojë kushtet e eksporteve të gazit. Dhe duke kërkuar që pagesat të bëhen vetëm përmes Gazprombankës, kjo lëvizje mund të bëjë që kjo bankë të shënjestrohet nga sanksione të mëtejme.

Nëse Putini po kërkonte për një pretekst për t'i ndaluar furnizimet me energji ruse për shtetet që mbështesin Ukrainën, ky vendim mund të shërbejë për këtë qëllim. Rusia ende po vazhdon të dërgojë gaz në Hungari - ku kryeministri populist, Viktor Orban, është pajtuar me sistemin e ri të pagesave të propozuar nga Putini - përmes sistemit të njëjtë të gazsjellësit.

Simone Tagliapietra, ekspert i energjisë dhe bashkëpunëtor në organizatën Bruegel me seli në Bruksel, thotë se "duke lëvizur në këtë drejtim, Rusia po përdor fragmentimin e BE-së - është strategjia 'përçaj dhe sundo' - prandaj ne kemi nevojë për një përgjigje të koordinuar të BE-së".



Si qëndron Evropa me furnizim të gazit?

Sanksionet e koordinuara të BE-së dhe Shteteve të Bashkuara nuk kanë prekur pagesat për naftë dhe gaz. Ky ishte koncesioni i Shtëpisë së Bardhë për aleatët evropianë, të cilët janë më të varur nga energjia ruse, që ofron 40 për qind të gazit të Evropës dhe 25 për qind të furnizimeve me naftë. Për energjinë ruse, Evropa paguan çdo ditë 850 milionë dollarë. Shumë persona nuk janë të lumtur që evropianët ende po blejnë energji nga Rusia, e cila mesatarisht fitoi 43 për qind të të ardhurave vjetore qeveritare nga shitjet e gazit dhe naftës në vitet 2011-2020, sipas Administratës amerikane për Informacione të Energjisë.

Vendimi i Rosisë për t'i zvogëluar shitjet e gazit para nisjes së luftës në Ukrainë, përveç përmes kontratave afatgjatë, kontribuoi në një krizë gjatë dimrit që rriti çmimet dhe shërbeu si alarm zgjimi se varësia e Evropës nga energjia ruse e la atë të pambrojtur. Por, lufta në Ukrainë ka treguar se duhet të ketë një rivlerësim të shpejtë të politikës energjetike që është në fuqi prej dekadash, përmes së cilës, gazi i lirë nga Rusia ka mbështetur ekonominë e Evropës.

Por, ndërprerja e furnizimeve të gazit në Evropë nuk i shkon për shtati as Rosisë.

Kur bëhet fjalë për naftën, në teori, Rusia mund ta eksportoje atë diku tjetër përmes anijeve, shembull në Indi apo Kinë, shtete që kanë nevojë për energji dhe që nuk janë pjesë e sanksioneve. Por, gazi është çështje tjetër. Sistemi i gazsjellësit nga depozitat e mëdha në Gadishullin Jamal të Rosisë, që sjell gazin në Evropë, nuk lidhet

me tubacionin e gazit që shkon për në Kinë dhe Rusia ka pak infrastrukturë për ta eksportuar gazin natyror përmes anijeve.

A do të mund t'i mbijetonte Evropa një ndërprerjeje të plotë të furnizimit me gaz?

Ekonomia e Evropës do të përballë me vështirësi pa gazin natyror rus, edhe pse ndikimi i një ndërprerjeje të plotë të furnizimit me gaz do të varej nga ajo se sa shumë e përdorin këtë produkt shtetet evropiane. Vlerësimet e ekonomistëve ndryshojnë shumë sa iu përket humbjeve që do të mund të kishte Evropa si tërësi. Analistët në Moody thanë në një studim të publikuar së fundmi se ndërprerja e plotë e energjisë - gazit dhe naftës ruse - do ta fuste Evropën në recesion.

Gjermania, ekonomia më e madhe në Evropë, varet shumë nga energjia ruse. Banka Qendrore gjermane ka deklaruar se një ndërprerje e plotë do të nënkuptonte humbje prej pesë pikësh të përqindjes së prodhimit ekonomik, si dhe rritje të inflacionit. Inflacioni veçse është në nivele rekorde, duke bërë që për shkak të rritjes së çmimeve të energjisë, edhe çmimet e tjera, nga ato të produkteve ushqimore e deri tek ato të lëndëve të para, të përjetojnë rritje.

Organizata Bruegel ka vlerësuar se Evropa do të kishte 10 deri në 15 për qind më pak sesa kërkesa normale për ta kaluar sezonin e ngrohjes gjatë dimrit të ardhshëm, që nënkupton se Evropa do të duhej të ndërmerre masa të jashtëzakonshme për ta zvogëluar përdorimin e gazit. Liderët evropianë kanë thënë se

ata nuk do të mund t'i përballojnë pasojat e një bojkoti të menjëhershëm. Në vend të kësaj, ata planifikojnë ta zvogëlojnë përdorimin e gazit rus sa më shpejt që të mundën. Liderët, po ashtu, kanë porositur më shumë gaz të lëngshëm natyror që transportohet me anije. Po ashtu, janë duke kërkuar alternativa të furnizimit, siç janë tubacionet nga vendet si Norvegjia dhe Azerbajxhani dhe, po ashtu, po punojnë për ngritjen e kapaciteteve të prodhimit të energjisë përmes erës dhe diellit dhe po nxisin masat për ruajtjen e gazit.

Qëllimi është që të hiqet dorë nga gazi rus për dy të tretat deri në fund të vitit dhe deri më 2027 Evropa të heqë dorë plotësisht nga gazi rus. Ende nuk dihet nëse ky qëllim do të arrihet, pasi furnizimet e gazit natyror janë të kufizuara, ndërkaq terminalet e eksportit kanë mbushur kapacitetet e tyre.

Gjermania, që nuk ka një terminal të importit, po mëton që të ndërtojë dy të tilla, por një gjë e tillë mund të kërkojë vite. Italia, që merr 40 për qind të gazit të saj nga Rusia, ka arritur marrëveshje për ta zëvendësuar gjysmën e kësaj sasive përmes importeve nga Algjeria, Azerbajxhani, Angola e Kongo dhe po shqyrton mundësinë që t'i rrisë importet edhe nga Katar. Evropa, po ashtu, është nën presion që t'i rimbushë depotë e saj nëntokësore në mënyrë që të ketë furnizime të mjaftueshme për dimrin e ardhshëm. Situata është mjaft serioze dhe e ka shtyrë Gjermaninë që ta shpallë fazën e parë - prej tri fazash - të planit të saj të emergjencës për energji.

Gati 47% e gjithë gazit natyror që ka hyrë në BE në tremujorin e parë të vitit 2021, ka ardhur nga Rusia. (Associated Press /Rel)

Pse i urrej indiferentët, mesazhi i Antonio Gramshit që është aktual edhe sot

Të jetosh do të thotë të marrësh anë, thoshte dikur Antonio Gramshi



Të jetosh do të thotë të marrësh anë, thoshte dikur Antonio Gramshi (1891-1937), themeluesi i Partisë Komuniste në Itali, i lindur në Ales më 22 janar 1891 dhe vdekur në Romë më 27 prill 1937. Një nga shkrimet e tij më të famshme, mban titullin emblemantik "I urrej indiferentët". Ai u botua për herë të parë në revistën "La città futura". Gramshi shpjegon se përse indiferenca e njerëzve është një nga të këqijat më të mëdha të një shoqërie. Ai e shkroi këtë ese në vitin 1917, kur Lufta e Parë Botërore nuk kishte përfunduar ende, dhe kur tensionet politike e sociale ishin shumë të forta.

Por fjalët e tij kanë një vlerë, e cila shtrihet përtej kontekstit historik në të cilin u konceptuan. Gjërat ndodhin nën një indiferencë të përgjithshme, dhe ne ankohemi zakonisht vetëm në retrospektivë, kur është tepër vonë. Teksti i plotë i shkrimit të 105 viteve më parë:

"Unë e urrej indiferentët. Besoj njëllor se Fridrih Hebel se "të jetosh, do të thotë të jesh partizan, të marrësh anë në një çështje". Në qytet nuk mund të ketë vetëm njerëz pa shtyllë kurizore, të pa interesuar mbi atë që ndodh përreth tyre. Ata që jetojnë vërtet, nuk mund të mos jenë qytetarë dhe të mos mbajnë anë.

Indiferenca është plogështi, parazitizëm, burracakëri, nuk është jetë. Prandaj unë e urrej indiferentët. Indiferenca është pesha e vdekur e historisë. Është

goditja fatale për novatorin, është materia inerte në të cilën ndjenjat entuziaste më të përndritura mbyten shpesh në moçalet e kufomave të qytetërimit të vjetër, të cilin e ruan më mirë se sa muret e fortesave, më mirë se sa gjoksi i luftëtarëve të saj.

Kjo pasi ajo i gëlltit trimat në thellësitë e tokës së etur, i dekurajon dhe ndonjëherë i bën edhe të tërhiqen nga ndërmarrja e tyre heroike. Indiferenca vepron fuqishëm në historinë njerëzore. Ajo vepron në mënyre pasive, por gjithsesi vepron. Ajo parathotë fatalitetin.

Ajo është e tillë që të lë pa mbështetje. Ajo është e tillë sa që të ç'organizon programet, t'i përmbys planet e thurura më së miri; është materia e papërpunuar që rebelohet me inteligjencën, dhe e ndrydh atë.

E keqja më e madhe që buron prej saj, është se në vend se të ketë përfitim nga një akt me vlera të mëdha për njerëzimin, ka humbje, për shkak të indiferencës së një grupi që vepron me mospjesëmarrjen e tij, me mungesën e tij numerike...

Ajo çfarë ndodh, nuk ndodh për shkak të një numri njerëzish që shpreson që kjo të ndodhë, por për shkak të kësaj mase që ligështohet, që heq dorë nga vullneti, që veçohet dhe i lë gjërat në dorë të fatit, që tërhiqet dhe lejon të lidhen të tilla nyje, që vetëm shpata mund ti zhbëjë, që lejon shpalljen e ligjeve që mund t'i shfuqizojë vetëm

rebelimi, që lejon të ngjiten në pushtet të tillë njerëz, që mund t'i përmbysë vetëm një kryengritje. Fataliteti që duket sikur e dominon historinë, nuk është asgjë përveçse pamja e gënjeshtërt e kësaj indiference, e kësaj mungese. Shumë prapaskena gatuhen në hije. Një numër i vogël njerëzish mund të veprojnë jashtë normave të kontrollit, duke ndryshuar strukturën e jetës së komunitetit, në një kohë që masa tjetër e injoron këtë veprim, dhe as që e vret mendjen të lodhet për një gjë të tillë.

Fatet e një brezi, mund të manipulohen për shkak të vizioneve dhe koncepteve të kufizuara, qëllimeve të çastit apo ambicieve dhe pasioneve vetjake të një grupi të vogël njerëzish, në një kohë që masa tjetër i injoron ato, dhe as do t'ia dijë për pasojat.

Por e keqja është se faktet dalin në skenë pasi janë pjekur, dhe vetëm atëherë, kur ka përfunduar pëlhura e endur në hije. Dhe pastaj duket sikur është fataliteti, ai që shkatërron gjithçka dhe të gjithë, duket sikur historia nuk është gjë tjetër përveç se një fenomen i jashtëzakonshëm natyror brenda të cilit ne jemi që të gjithë viktima, dashje pa dashje, me ose pa dëshirën tonë, me ose pa dijeninë tonë, edhe nëse kemi vepruar apo kemi qenë indiferentë.

Dhe së fundi, kjo masë njerëzish inatoset, dëshiron të shpëtojë nga pasojat, duke kërkuar se kush është fajtori, dhe duke i larguar

përgjegjësitë nga vetvetja. Disa madje ankohen me devocion, të tjerë mallkojnë në mënyrë të turpshme, por asnjëri prej tyre nuk i bën pyetjen vetes: në qoftë se do ta kisha kryer edhe unë detyrën time, apo nëse do të kisha tentuar ta pohoja dëshirën, këshillën time, a do të kishte ndodhur vallë kjo që ndodhi?

Por askush ose pak njerëz mund të fajësojnë veten, se kjo ndodhi për shkak të indiferencës, skepticizmit të tyre. Apo sepse nuk ja dhanë ndihmën në kohën e duhur atij grupi që kishte një ndjenjë të lartë qytetarie, dhe që me të drejtë, për të evituar të keqen, propozoi të luftonte për triumfin e drejtësisë.

Përkundrazi, pjesa më e madhe e tyre, preferojnë të flasin për dështimin e idealeve, të programeve të shkatërruara përgjithmonë e banaliteteve të tjera të ngjashme me to. Ata rifillojnë kështu që t'i shmangen plotësisht përgjegjësisë.

Dhe kjo nuk ndodh vetëm sepse ata nuk i shohin qartë gjërat, apo nuk janë në gjendje të gjejnë zgjidhje për problemet më urgjente. Problemi është se këto zgjidhje mbesin gjithnjë shterpë, dhe se kontributi i tyre në jetën e komunitetit nuk nxitet nga asnjë ndjenjë morale.

Ai është vetëm produkt i kuriozitetit intelektual dhe aspak i një ndjenjë e fortë të përgjegjësisë historike, e cila duhet të na përfshijë të gjithëve, dhe që nuk pranon as agnosticizëm e as

indiferencë, e cilitdo lloji qoftë.

Unë i përbuz indiferentët edhe sepse më bezdisin ankesat qaramane të këtyre "të pafajshmëve të përjetshëm". I kërkoj llogari secilit prej tyre mbi mënyrën se si e ka kryer detyrën ndaj jetës për atë që ajo i ka falur, dhe i fal çdo ditë për atë që kanë bërë e për atë që nuk kanë bërë.

Dhe e ndjej për detyrë të mos kem mëshirë për ta, të mos i ndaj lotët e mija me të tyre. Unë jam partizan; jetoj dhe ndihem burror në ndërgjegjen time, pasi luftoj për lumturinë e së ardhmes, të cilën e ndërton e gjithë qenia ime.

Dhe brenda saj, zinxhiri social nuk bazohet mbi një numër të vogël elementesh. Brenda saj, asgjë që ndodh nuk është rastësi apo fatalitet, por është vepra inteligjente e qytetarëve. Ndërgjegjja ime nuk mund të pranojë asnjë njeri që qëndron në dritare dhe bën sehir, gjatë kohës që një numër i vogël njerëzish sakrifkohen e derdhen gjakun në këtë sakrificë.

Dhe ata që dalin në dritare vetëm për të parë, ata që e kanë mbushur jetën vetëm me atë pak gjë që mund t'i ketë ofruar aktiviteti i tij personal, dhe që e shfryjnë dufin duke poshtëruar të sakrifkuarin, atë që është përgjakur, vetëm pse sakrificë e tjetrit nuk ja ka përmbushur synimet e tij, këta unë nuk mund t'i pranoj. Unë jetoj, jam një partizan. Prandaj, i përbuz të gjithë ata që nuk marrin anë. I urrej indiferentët. / *Libreriamo - Bota.al*

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Ballkani mund Dritën, i ofrohet edhe më shumë titullit kampion

Ballkani është edhe me afër titullit kampion në elitën e futbollit të Kosovës, pasi të enjten e ka mposhtur në derbi Dritën e Gjilanit (3-2). Në kuadër të javës së 31-të, tri pikë i ka fituar edhe skuadra e Llapit që arriti të shënojë fitore 2-0 ndaj Malishevës



një fitore të madhe në përballje me skuadrën e Malishevës (0-0). Pjesa e parë e ndeshjes përfundoi me rezultat 0-0, kurse në minutën e 56 Arbnoor Ramadani realizoi një gol të bukur për 0-1, kurse rezultat

final 0-2 e vulosi Adem Maliqi në minutën e gjashtë shtesë. Pas këtyre tri pikëve, Llapi ngrihet në kuotën e 53 pikëve dhe ka vetëm dy pikë më pak se Gjilani dhe tri pikë më pak se Drita që renditen në pozitat tre

BKT SUPERLIGA		
Ballkani - Drita		
Malisheva - Llapi		
Gjilani - Prishtina	1-2	
Drenica - Ulpiana	3-1	
Dukagjini - Feronikeli	4-0	
TABELA		
		PIKË
1. Ballkani	31	69
2. Drita	31	55
3. Gjilani	31	55
4. Llapi	31	53
5. Prishtina	31	42
6. Dukagjini	31	39
7. Drenica	31	39
8. Malisheva	31	37
9. Ulpiana	31	24
10. Feronikeli	31	12

dhe dy. Ndërsa skuadra e Malishevës është në pozitën e tetë me 37 pikë.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

Prishtinë, 28 prill - Ballkani ka shënuar fitore në derbin ndaj Dritës me rezultat 3-2 dhe në këtë mënyrë i është afruar edhe më shumë titullit të kampionit në BKT Superligë. Skuadra e Dritës, edhe përkundër asaj që ishte duke humbur me dy gola diferencë, arriti të rikthehet dhe ta barazojë rezultatit në 2-2, por në minutën e gjashtë shtesë Ballkani shënoi golin e fitores. Në pjesën e parë gola nuk pati

(0-0). Pesë minuta pasi filloi pjesa e dytë e ndeshjes, Ilir Blakçorri realizoi autogol për rezultatit 1-0. Katër minuta më vonë shënoi Nazmi Gripshi për 2-0. Mysafirët u rikthyen dhe barazuan rezultatit në 2-2 me golat e shënuara nga Kryeziu dhe Tahiri, por Ermal Krasniqi në minutën e gjashtë shtesë shënoi golin e fitores për skuadrën vendase. Ballkani gjendet në pozitën e parë me 69 pikë, 14 më shumë se ndjekësja më e afërt, që është Drita. Skuadra e Llapit ka regjistruar

Kampionet e Penzës priten nga kryetari i Pejës, Gazmend Muhaxheri

Pejë, 28 prill - Kryetari i komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, me bashkëpunëtorë, ka pritur në takim përfaqësuesit e KBF Penza, të cilat janë shpallur kampione e Kosovës në Superligën e femrave për edicionin 2021-2022. Klubi pejan e ka mbrojtur titullin e fituar në edicionin e kaluar. Kryetari Muhaxheri e ka uruar skuadrën e Penzës për sukseset e arritura deri më sot dhe i ka

dëshiruar suksese edhe në të ardhmen, ndërsa KBF Penza e ka falënderuar kryetarin Muhaxheri për përkrahjen dhe e ka njoftuar se këtë vit i kanë sjellë tri kupa, derisa sukseset janë vetëm duke u rritur. Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport në komunën e Pejës, Xhenet Syka-Kelmendi, i ka falënderuar vashat të cilat kanë dhënë maksimumin në të gjitha

fushat sportive dhe vazhdojnë ta japin maksimumin. "Peja është qyteti i basketbollit dhe kemi njerëz, që një jetë të tërë ia kanë kushtuar sportit, por kurora më e bukur e basketbollit në Pejë është KBF Penza, prandaj e kemi prioritet masovizimin e sportit të vajzat. Ju do të jeni një shembull i mirë i modelit se vajzat kur duan ia dalin", ka deklaruar Xhenet Syka-Kelmendi.



Ekipi i xhudos i kthehet Evropianit

PRISHTINË, 28 PRILL - Ekipi i xhudos do t'i kthehet Kampionatit Evropian. Nga e premija e deri më 1 maj do të mbahet në Sofia të Bullgarisë. Në Evropianin e fundit, të mbajtur në Lisbonë të Portugalisë, ekipi i xhudos fitoi tri medalje, dy të arta dhe një të bronzte, me ç'rast e mbylli kampionatin në vendin e parë për nga numri i medaljeve të arta. Këtë herë ekipi do të përbëhet nga dy kampionët e


Evropës nga viti i kaluar, Distria Krasniqi dhe Akil Gjakova, si dhe Flaka Loxha e Laura Fazliu. Kampionia olimpike, Krasniqi, garon në kategorinë deri në 52 kilogramë, Gjakova në -73 kg, Loxha në -57 dhe Fazliu në -63 kg. Kampionia olimpike, Nora Gjakova dhe medalistja e bronzte e botës 2019, Lorianana Kuka, do të mungojnë shkaku i lëndimeve. Distria dhe Flaka garojnë sot (e premte), ndërsa Laura e Akili (e shtunë).

Kryetari i Mitrovicës, Bedri Hamza, priti në takim kryetarin e FFK-së, Agim Ademi

MITROVICË, 28 PRILL - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka pritur në takim kryetarin e Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, së bashku me ekipin e tij. Në këtë takim ishte e pranishme edhe kryesuesja e Kuvendit

Komunal e Mitrovicës, Vesa Broja. "Është biseduar për zhvillimin e sportit, me theks të veçantë futbollin, bashkëpunimin institucional dhe projektet e përbashkëta në dobi të masivizimit të sportit. Nga ky takim është bërë me dije

se në ditët në vijim pritet finalizimi i marrëveshjes për financimin e dy projekteve të fushave të futbollit: njëri për ligën rajonale, tjetri për nevojën e qytetarëve", thuhet në njoftimin e komunës së Mitrovicës.



Hamiltoni: Kam pilotuar makinë edhe më të keqe se kjo

LONDËR, 28 PRILL - Kriza e rezultateve që ka shoqëruar këtë sezon shtatë herë kampionin e botës në Formula 1, britanikun Lewis Hamilton, ka bërë që ai të heqë dorë nga titulli kampion. Gjithsesi, ai pranon se falë punës që ai dhe skuadra do të bëjnë do të kalojnë këtë krizë dhe do t'ia

dalin mbanë. "Makina nuk mund të pilotohet, por unë s'heq dorë", ka thënë Hamiltoni. "Njerëzit më shohin dhe më thonë se kam fituar gjithnjë pasi kam pasur një makinë të mirë dhe se kurrë nuk kam pilotuar një makinë të keqe. Unë mund t'ju garantoj se kjo ka ndodhur

edhe më parë. Makina McLaren e vitit 2009 ishte më keq se kjo e sotnja. Ajo ka qenë makina më e keqe që kam pilotuar në karrierën time në Formula 1", u shpreh Hamilton. "Ju garantoj se makina Mercedes W13 e këtij viti ka më shumë potencial se kaq. E njëjta gjë na ndodhi edhe në

vitin 2009 me makinën McLaren, pasi ishim në gjendje ta zhvillonim më tej atë makinë përgjatë sezonit. Dhe më pas ishim në majë. Ndaj kam besim se të njëjtën gjë do të bëjmë edhe këtë vit, për të qenë sërish kompetitivë", ka shtuar piloti britanik.



UEFA më 11 maj do të diskutojë ndryshimet e reja në Ligën e Kampionëve

VJENË, 28 PRILL - Më 11 maj UEFA do ta mbajë kongresin e saj vjetor në Vjenë dhe një nga temat që do të diskutohet është një format i ri konkurrues potencial për Ligën e Kampionëve, i cili do të hyjë në fuqi nga viti 2024. Plani i fundit i organit qeverisës të futbollit evropian nuk ishte aspak tërheqës dhe UEFA po përpiqet të gjejë një formulë të re për t'i dhënë një shtysë të madhe kompeticionit të madh. Javë më parë presidenti i Paris Saint-Germainit dhe i Shoqatës Evropiane të Klubeve (ECA), Nasser Al-Khelaifi, diskutuan idenë e UEFA-s për të mbajtur një format të stilit Final Four në qytetin e zgjedhur si vendi i asaj që ka qenë finalja e kompeticionit deri më tani. Sipas "Times", ideja po merr formë dhe mund të jetë një nga ndryshimet e para që do të prezantohet në të ardhmen e afërt. Presidenti i UEFA-s, Aleksander Ceferin, zbuloi se ndryshimet mund të shpallen në maj, me UEFA-n që mendon për idenë për t'u dhënë dy vend skuadrave



bazuar në rekordin e tyre historik në Evropë gjatë pesë vjetëve, nëse ato dështojnë të kualifikohen përmes paraqitjeve të tyre vendase. UEFA beson se duke pritur një Final Four në një terren neutral do të ketë më shumë fitime televizive, si dhe apel më të madh komercial. Ata po studiojnë mundësinë që liga e pestë me performancën më të mirë pas Anglisë, Spanjës, Italisë

dhe Gjermanisë të marrë një vend shtesë. Sipas formatit që ishte miratuar në të kaluarën, në fazën e grupeve do të ishin 10 ndeshje, ku skuadrat do të luanin po aq ndeshje në shtëpi si jashtë. Renditja përfundimtare nuk do të ndahet sipas grupeve, me tetë më të mirat nga 36 skuadrat pjesëmarrëse që shkojnë drejtpërdrejt në raundin e 16.

Milwaukee dhe Golden State në gjysmëfinale, eliminojnë Chicago e Denveri

MILWAUKEE, 28 PRILL - Skuadra kampione e Milwaukee Bucksit avancojnë në gjysmëfinalen e "play-off"-it në Konferencën e Lindjes pas fitores me rezultat 116-100 ndaj Chicago Bullsit. Ndeshje e komanduar dhe fitore e merituar për Bucksin, që fitoi 4-1 serinë e çerekfinaleve. Antetokounmpo me 33 pikë ishte lider për



Milwaukee, që në gjysmëfinale do të luajë ndaj Bostonit. Në Perëndim një biletë për në gjysmëfinalen e "play-off"-it ka siguruar edhe ekipi i Golden States, që e mposhti me vështirësi 102-98 Denverin dhe fitoi 4-1

serinë e takimeve. Një sfidë e ekuilibruar deri në fund, ku për Warriorsin u dallua Stephen Curry, autor i 30 pikëve. Po 30 pikë e 19 rebounde realizoi edhe Doniqi për miqtë, por që s'mjaftuan.

KONFERENCA E LINDJES - ÇEREKFINALE "PLAY-OFF"

Miami - Atlanta	(4-1)
Philadelphia - Toronto	(3-2)
Milwaukee - Chicago	116-100 (4-1)
Boston - Brooklyn	(4-0)

KONFERENCA E PERËNDIMIT - ÇEREKFINALE "PLAY-OFF"

Phoenix - New Orleans	(3-2)
Dallas - Utah Jazz	(3-2)
Golden State - Denver	102-98 (4-1)
Memphis - Minnesota	(3-2)

Halleri pritët të jetë pasardhës i Lewandowskit në Bayern

Bayern Muncheni e ka gjetur pasardhësin e Roberto Lewandowskit, i cili pritët t'i japë fund aventurës në Bayern.

Barcelona është kandidatja kryesore për t'i siguruar shërbimet e sulmuesit polak për sezonin e ardhshëm dhe kampionët

e Gjermanisë do të duhet të gjejnë një numër 9 të ri për ta zënë vendin e tij. Lojtari i zgjedhur nga Bayerni, siç ka bërë me dije

e përditshmja spanjolle "Diario AS", duket se është sulmuesi i Ajaxit, Sebastian Haller. 27-vjeçari ka shënuar 33 gola

për Ajaxin deri tani në këtë sezon dhe duket se është kontaktuar nga drejtuesit e klubit bavarez në ditët e kaluara.

SHKURT

Klopp: Finalja? Është zhvilluar vetëm ndeshja e parë

Liverpooli e mposhti Villarrealin në ndeshjen e parë me rezultat 2-0, por trajneri Jurgen Kloppi është me këmbë në tokë. Ai ka thënë se, pavarësisht prej fitores, Liverpooli duhet të jetë shumë i kujdesshëm në ndeshjen e dytë në Spanjë. "Nuk ishte një ndeshje e lehtë, veçanërisht në pjesën e parë. Por kur ushtruar presion, filluan që gjërat të shkonin siç duhej dhe ne vendosëm në vështirësi kundërshtarët tanë. Afër finales? Vështirë të mendohet, jemi vetëm në ndeshjen e parë. Nuk mund të jemi të relaksuar se fituam ndeshjen e parë, duhet të punojmë shumë dhe të tregohemi të kujdesshëm në Spanjë, ndeshja e kthimit do të jetë më e vështirë", ka thënë Kloppi.

Emery: Gjërat mund të shkonin edhe më keq

Villarreali pësoi humbje në ndeshjen e parë gjysmëfinale nga Liverpooli (2-0). Trajneri Unai Emery e ka pranuar se gjërat kanë mundur të shkojnë edhe më keq. "Në këtë fazë të Ligës së Kampionëve takohesh me rivalë që janë favoritë. Ata nuk na lanë të kishin iniciativën, nuk na lanë t'i ndiqnim. Në ndeshjen e kthimit besoj se do të jetë ndryshe. Mendoj se do të bëjmë diçka. Në e dinim që Liverpooli është një skuadër e fortë. Mund të shkonte edhe më keq, por në Spanjë do të provojmë diçka ndryshe", ka thënë Emery.

Inzaghi, pas humbjes nga Bologna: Ka shumë zhgënjim

Interi ka pësuar një humbje shokuese në udhëtim te Bologna 2-1 falë një gabimi skandaloz nga portieri Andrei Radu. Pas kësaj humbje, tani gjasat e Interit për titull zvogëlohen, pasi jo gjithçka varet nga rezultatet e tyre. Pas ndeshjes trajneri Simone Inzaghi ka thënë se kjo humbje është zhgënjyese, por që duhet të luftojnë në katër ndeshjet e mbetura pavarësisht se titulli nuk është që varet nga rezultatet e tyre. "Pas një humbjeje si kjo, ka shumë zhgënjim dhe kjo është normale, por duhet të reagojmë shpejt. Titulli nuk është në dorën tonë, por jemi vetëm dy pikë larg kreut dhe ka ende edhe katër javë. Gjithçka mund të rikuperohet", ka thënë Inzaghi.

Pochettino: Unë dhe Mbappe do të qëndrojmë 100 % në PSG

Paris, 28 prill - Trajneri i PSG-së, Mauricio Pochettino, ka konfirmuar se do të qëndrojë te skuadra franceze. Pochettino nuk kishte një sezon edhe aq të mirë, me ekipin e mbushur me yje që nuk arriti suksesin e pritshëm në Ligën e Kampionëve. Megjithatë, Pochettino ka konfirmuar se do të jetë pjesë e skuadrës edhe për sezonin tjetër. Por, ai ka thënë se edhe Kylian Mbappe nuk do të largohet, dhe se është 100 % i bindur për këtë gjë. "Momentalisht mund t'ju konfirmoj, unë do të qëndroj 100 % dhe e njëjta gjë vlen edhe për Kylian Mbappen", ka thënë Mbappe.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj/>



KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË FERIZAJT

Nr. _____
Datë: 28.04.2022

Në bazë të nenit 3 paragrafët 1 nën-paragrafët 2,3,11 neni 6 paragrafi 1 si dhe të nenit 8 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10 e datës 03 Prill 2019), për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 5 paragrafi 1, Nën-paragrafi 1.2, neneve 8, 9, 10, 11 dhe 12 të Rregullores së Qeverisë së Kosovës Nr. 09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, e në zbatim të Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës 01. Nr. 45 të dt. 28.02.2022, për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës dhe objekteve të komunës, si dhe në zbatim të përgjegjësisve sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës, 01. Nr. 29, të dt. 28.01.2022, për themelimin e Komisionit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Komisioni Vlerësues në mbledhjen e mbajtur me datën 28.04.2022, vendos për shpalljen e :

ANKANDIT PUBLIK

Për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës dhe objekteve komunale në shfrytëzim afatshkurtër.

I. JEPEN në shfrytëzim afatshkurtër, prej 15 vite, pronat e Komunës së Ferizajt.

Dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim u jepet organizatave të shoqërisë civile që kanë për qëllim ushtrimin e veprimtarisë në kuadër të kompetencave të Komunës, më poshtë gjendet lista e pronave dhe objekteve të Komunës, të cilat janë përcaktuar me vendim të Kuvendit të Komunës.

Nr	Vendi i Dhënies në Shfrytëzim të Pronës	Adresa e Pronës	Sipërfaqja m ²	Çmimi vjctor
1	Parcelat 1. P-72217092-00572-0; 2. P-72217092-00570-1; P-72217092-00569-1;	Rr "Skënderbeu"	1100 m ²	12 Euro në vit

Kriteret për vlerësimin e ofertave

- Vlera e çmimit të ofruar nga ofertuesi;
- Projekti ideor për ndërtimin e objektit dhe vlera e investimit për ndërtimin e objektit për trajtimin e persona me nevoja të veçanta nga organizata joqeveritare.

Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në Ankandin Publik

- Të drejtë pjesëmarrje dhe konkurrimi, kanë të gjitha organizatat joqeveritare, fushëveprimi i të cilave është mbështetja për persona me nevoja të veçanta.
- Dhënia e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim u jepet organizatave të shoqërisë civile që kanë për qëllim ushtrimin e veprimtarisë në kuadër të kompetencave të Komunës.
- Procedurat e konkurrimit bëhen vetëm për organizatat e shoqërisë civile jo fitimprurëse të cilat veprojnë në territorin e Komunës përkatëse.

Veprimtaria që mund të ushtrohet

- Veprimtari që mund të ushtrohet është përkujdesja ndaj personave me nevoja të veçanta dhe përfaqësimi i të drejtave të tyre.

II. Dokumentet e nevojshme për aplikim

- Fletë aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar;
- Letërnjoftimi kopje;
- Çertifikata e regjistrimit të OJQ-së, certifikata e numrit fiskal dhe statuti i OJQ-së;
- Dëshmi mbi përmbushjen e obligimeve tatimore ndaj ATK-së;
- Dëshmi mbi përmbushjen e obligimeve ndaj Komunës: Paga e obligimeve - Tatimi në Pronë.
- Pala e cila përfiton në Ankandin Publik para se të nënshkruaj kontratën me Komunën duhet të bëjë pagesën e qirasë për (1) vit paraprakisht. Paga duhet të bëhet sipas vlerës së ofertuar nga pala përfituese në xhirollogarinë e Komunës.**
- Në rast se përfituesi i parë apo i dytë tërhiqen nga konkurrimi atëherë vjen në shprehje pala e renditur e dyta, përkatësisht e treta.**

III. Ankandi Publik do të jetë i hapur për 15 ditë kalendarike:

- Nga data 28.04.2022 deri me datën 12.05.2022 ora 16.00.
- Ankandi Publik do të jetë në ueb-faqe të Komunës së Ferizajt, tabelën e shpalljeve të Komunës dhe në një gazetë ditore;
- Oferta duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur dhe me ngjyrë të bardhë pa asnjë shenjë identifikuese,
- Hapja publike e ofertave bëhet datën 16.05.2022 në ora 10.00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

IV. Tërheqja e aplikacioneve-kopje fizike dhe elektronike, mund të bëhet në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve në hyrje të Komunës së Ferizajt, çdo ditë pune prej ora 08.00 deri në ora 16.00.

V. Dorëzimi i ofertave bëhet në formë të mbyllur në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, e cila protokollohet si e tillë.

VI. Të interesuarit mund të informohen (çdo ditë pune) përmes:

- Ueb faqes <http://kk.rks-gov.net/ferizaj/>
- Telefonit: 038/200/46-076
- E-mail adresës: info.ferizaj@rks-gov.net

VII. Pronat në shfrytëzim jepet në gjendjen aktuale. Komuna e Ferizajt nuk merr përsipër asnjë investim dhe nuk njih asnjë investim pas përfundimit të kontratës.

VIII. Tërheqja e aplikantëve nga ankandi publik, mund të bëhet jo më vonë se tre (3) ditë para hapjes së ofertave.

Kryesuesi i Komisionit Vlerësues

Balton Derguti



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj/>



KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË FERIZAJT

Nr. _____
Datë: 28.04.2022

Në bazë të nenit 3 paragrafët 1 nën-paragrafët 2,3,11 neni 6 paragrafi 1 si dhe të nenit 8 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10 e datës 03 Prill 2019), për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 5 paragrafi 1, Nën-paragrafi 1.2, neneve 8, 9, 10, 11 dhe 12 të Rregullores së Qeverisë së Kosovës Nr. 09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, e në zbatim të Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës 01. Nr. 44 të dt. 28.02.2022, për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës dhe objekteve të komunës, si dhe në zbatim të përgjegjësisve sipas vendimit të Kuvendit të Komunës, 01. Nr. 29, të dt. 28.01.2022, për themelimin e Komisionit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Komisioni Vlerësues në mbledhjen e mbajtur me datën 28.04.2022, vendos për shpalljen e :

ANKANDIT PUBLIK

Për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër, të pronës dhe objekteve komunale në shfrytëzim afatshkurtër.

I. JEPEN në shfrytëzim afatshkurtër, prej 15 vite, pronat dhe objektet e Komunës.

Më poshtë gjendet lista e pronave dhe objekteve të Komunës, të cilat janë përcaktuar me vendim të Kuvendit të Komunës që të jepet në shfrytëzim për personat fizik dhe për personat juridik.

Nr	Vendi i Dhënies në Shfrytëzim të Pronës	Adresa e Pronës	Sipërfaqja m ²	Çmimi fillestar
1	Lokali afarist brenda objektit banesor Inxhinering sh.p.k me nr. P-72217092-00714-4-22-2-1-0	Rr "Uran Tinova"	22.88 m ²	114.40 Euro
2	Lokali afarist me nr. P-72217092-1-3-1-0	Rr "Ramadan Rexhepi"	101.62 m ²	508.10 Euro

Kriteret për vlerësimin e ofertave

- Vlera e çmimit të ofruar nga ofertuesi

Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në Ankandin Publik

- Të drejtë pjesëmarrje dhe konkurrimi, kanë të gjithë personat fizik dhe juridik të Republikës së Kosovës dhe investitorët e huaj.

Veprimtaria që mund të ushtrohet

Veprimtari që mund të ushtrohet duhet të jetë e lejuar sipas normave morale, ligjore dhe rregullave tjera që parashihen me ligj. Veprimtaritë të cilat cenojnë rendin juridik dhe moral si dhe janë pengesë për banorët nuk do të jepet prona në shfrytëzim.

II. Dokumentet e nevojshme për aplikim

- Fletë aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar;
- Letërnjoftimi kopje;
- Çertifikata e regjistrimit të biznesit (për subjekte juridike);
- Dëshmi mbi përmbushjen e obligimeve tatimore ndaj ATK-së (për bizneset vendore);
- Dëshmi mbi përmbushjen e obligimeve ndaj Komunës: Paga e tatimit në Pronë
- Dëshmi mbi numrin aktual të punësuarve (për kompanitë ekzistuese);
- Pala e cila përfiton në Ankandin Publik para se të nënshkruaj kontratën me Komunën duhet të bëjë pagesën e qirasë për (3) tre muaj paraprakisht. Paga duhet të bëhet sipas vlerës së ofertuar nga pala përfituese në xhirollogarinë e Komunës.**
- Në rast se përfituesi i parë apo i dytë tërhiqen nga konkurrimi atëherë vjen në shprehje pala e renditur e dyta, përkatësisht e treta.**

III. Ankandi Publik do të jetë i hapur për 15 ditë kalendarike:

- Nga data 28.04.2022 deri me datën 12.05.2022 ora 16:00.
- Ankandi Publik do të jetë në ueb-faqe të Komunës së Ferizajt, tabelën e shpalljeve të Komunës dhe në një gazetë ditore si dhe në lokalim afarist i cili jepet në shfrytëzim,
- Oferta duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur dhe me ngjyrë të bardhë pa asnjë shenjë identifikuese,
- Hapja publike e ofertave bëhet datën 16.05.2022 në ora 10.00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

IV. Tërheqja e aplikacioneve-kopje fizike dhe elektronike, mund të bëhet në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve në hyrje të Komunës së Ferizajt, çdo ditë pune prej ora 08.00 deri në ora 16.00.

V. Dorëzimi i ofertave bëhet në formë të mbyllur në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, e cila protokollohet si e tillë.

VI. Të interesuarit mund të informohen (çdo ditë pune) përmes:

- Ueb faqes <http://kk.rks-gov.net/ferizaj/>
- Telefonit: 038/200/46-076
- E-mail adresës: info.ferizaj@rks-gov.net

VII. Lokali në shfrytëzim jepet në gjendjen aktuale. Komuna e Ferizajt nuk merr përsipër asnjë investim dhe nuk njih asnjë investim pas përfundimit të kontratës.

VIII. Tërheqja e aplikantëve nga ankandi publik, mund të bëhet jo më vonë se tre (3) ditë para hapjes së ofertave.

Kryesuesi i Komisionit Vlerësues i Ofertave

Balton Derguti





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren - Prizren Beledijesi

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT PRIZREN

Dh. 00008339
Datë: 19.04.2022

Bazuar në nenin 20 paragrafi 1, të Ligjit nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 5, pika (d) të Ligjit nr. 03/L-068 për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, Udhëzimit administrativ (MASHT) për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës-drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm nr. 151/2020 të datës 22.12.2020, Drejtoria Komonale e Arsimit në Prizren, shpall:

KONKURS

Pozita: Drejtor i shkollës

Në shkollat fillore, të mesme të ulëta:

1. ShFMU "Lidhja e Prizrenit" në Prizren;
2. ShFMU "Emin Duraku" në Prizren;
3. ShFMU "Lekë Dukagjini" në Prizren;
4. ShFMU "Mati Logoreci" në Prizren;
5. ShFMU "Mustafa Baku" në Prizren;
6. ShFMU "Haziz Tola" në Prizren;
7. ShFMU "Xhevat Berisha" në Prizren;
8. ShFMU "Heronjtë e Lumës" në Vërmicë;
9. ShFMU "Dëshmorët e Hasit" në Kabash-Has;
10. ShFMU "Shtjefën Gjeçovi" në Zym;
11. ShFMU "Hysni Temaj" në Kushnin;
12. ShFMU "Bajram Curri" në Romaj;
13. ShFMU "Pjetër Budi" në Lugishtë - Has;
14. ShFMU "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" në Mazrek;
15. ShFMU "Mit'hat Frashëri" në Krajk;
16. ShFMU "Liugj Gurakuqi" në Nashec;
17. ShFMU "17 Shkurti" në Atmaxhë;
18. ShFMU "26 Marsi" në Landovicë;
19. ShFMU "Dëshmorët e Kabashit" në Korishë;
20. ShFMU "Besim Nrecaj" në Lutogllavë;
21. ShFMU "Ekrem Rexha" në Lubizhdë;
22. ShFMU "Nefit Jusufi" në Skorobishtë;
23. ShFMU "Naim Frashëri" në Vlashnje;
24. ShFMU "Anif Muji" në Struzhë;
25. ShFMU "Gmçare" në Gërçare;
26. ShFMU "Meto Bajraktari" në Reqanë;
27. ShFMU "Sharr" në Jabllanicë;
28. ShFMU "Svjetlost" në Manastericë;
29. Çerdha "Zambaku" në Prizren.

Në shkollat e mesme të larta:

1. Gjinnazi "Gjon Buzuku" në Prizren;
2. Gjinnazi "Remzi Ademaj" në Prizren;
3. SHMLP "Luciano Motroni" në Prizren;
4. SHMLM "Ymer Prizreni" në Prizren.

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidati/ja për të marrë pjesë në konkurs:

1. Kandidati/ja i/e interesuar duhet t'i plotësojë këto kushte:
